

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetare, Xhevdet Abazi dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh.K. nga Prishtina, për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nën par. 3 të KPRK-së, duke vendosur për ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Sh.K., av. B.J., të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore – DKR në Prishtinë, PKR.nr.264/16 datë 21.06.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, më datë 22.09.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit Sh.K., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore – DKR në Prishtinë, PKR.nr.264/16 datë 21.06.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore – DKR në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.264/16 datë 21.06.2017, e ka shpallur fajtor të akuzuarin Sh.K., për veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nën par. 3 të KPRK-së, dhe për këtë vepër penale e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) vjetësh, në të cilin i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 04.12.2015 e tutje. Me aktgjykimin e ankimuar, të akuzuarit gjykata e shkallës së parë, i ka shqiptuar edhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, ashtu që koha e kaluar në Institucionin e kujdesit shëndetësor do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim. Shpenzimet e procedurës penale kanë mbetur barrë e mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur:

-Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.K., av. B.J., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, apo të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, për të cilën njoftoi Prokurorin e Apelit, të dëmtuarit, të akuzuarin dhe mbrojtësit e tij. Në seancën e kolegjit ishin të pranishëm mbrojtësi i të akuzuarit av. B.J., i akuzuari Sh.K., e dëmtuara SH.G. ndërsa, edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit. Në seancën e kolegjit e dëmtuara SH.G., deklaroi se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit pasi më parë sqaroi disa nga pretendimet ankimore, ngeli në tërësi pranë propozimeve si në ankesë të cilën e përkrahu edhe i akuzuari Sh.K..

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA.nr.387/17 datë 23.08.2017, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës.

Në ankesën e paraqitur të mbrojtësit të akuzuarit, pretendohet se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara sipas dispozitës së nenit 384 par.1 nën par.12 e lidhur me nenet 370 par. 8 të KPRK, mirëpo, nga arsyetimi i ankesës në fjalë, rezulton se pretendimet ankimore kanë të bëjnë kryesisht me vendimin për dënim, duke konstatuar se gjykata e shkallës së parë, nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare që kanë të bëjnë me vendimin për dënim, ngase gjithherë sipas pretendimeve ankimore, duke pasur parasysh veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor atëherë pa dyshim rezulton se dënimi i shqiptuar është i ashpër. Më tutje, në vazhdim të ankesës pretendohet se kur merret parasysh dënimi që i është shqiptuar të akuzuarit

por edhe vepra penale për të cilën është shpallur fajtor atëherë edhe arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar sidomos përkitazi me vendimin për dënim është dashur të jetë më i gjerë e jo sikur që ka vepruar gjykata e shkallës së parë, duke aluduar kështu se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12 të KPPK-së.

Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të cekura si më lartë nuk qëndrojnë, nga se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë e as shkelje tjera të cilat kjo gjykatë i shqyrton edhe sipas detyrës zyrtare, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, konkret, nuk përmban kundërthënie me vetë veten, e as me arsyetimin e tij, ngase, gjykata e shkallës së parë në dispozitiv ka paraqitur të gjitha faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën i akuzuari edhe është shpallur fajtor, pra, nga përmbajtja e dispozitivit pa dyshim që rezulton se kemi të bëjmë me vepër penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 3 të KPRK-së, ngase, në rastin konkret i akuzuari ka privuar nga jeta gjyshin e tij-tani të ndjerin Ismail Kastrati, pra, anëtarin e familjes me të cilin i akuzuari ka jetuar në bashkësi familjare.

Po ashtu, edhe në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe juridike, të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë, duke vënë në dukje se cilat fakte dhe për çfarë arsyesash i merr si të provuara ose të pa provuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore konform dispozitave të nenit 370 par.7 të KPPK. Gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i paraqitur lidhur me këto përfundimet e veta, të cilat si të drejta e të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Kështu në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, përkitazi me fakte vendimtare, përveç mbrojtjes së të akuzuarit, i cili nuk i konteston faktet se natën kritike i akuzuari Sh.K. ka qenë në shtëpinë e tij së bashku me gjyshin-tani të ndjerin Ismail Kastrati dhe se në shtëpi nuk ka qenë askush tjetër derisa të nesërmen në shtëpi ka ardhur motra e tij, i cili – pra, i akuzuari nuk ia ka hapur derën gjatë tërë natës deri në nesërmen në orët e pasdites, ku motra e tij – Serenata është futur në shtëpi përmes një dritare nga pjesa e prapme duke e thyer xhamin e dritares, për çka pastaj i akuzuari e njofton se gjyshi ka vdekur, pastaj ka marrë parasysh edhe deklaratën e dëshmitares S.K. – motra e të akuzuarit, e cila përveç që ka vërtetuar faktet dhe rrethanat që i deklaron edhe vetë i akuzuari, nga e njëjta gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar edhe faktet se, pasi dëshmitarja futet në shtëpi tani të ndjerin I.K.n e gjen të vdekur në dhomën e tij të fjetjes, ku për këtë i akuzuari i ka thënë se është vrarë me armë zjarri, e gjithashtu janë vërtetuar edhe faktet dhe rrethanat përkitazi me gjendjen shëndetësore të akuzuarit, e të cilat fakte dhe rrethana vërtetohen edhe nga

dëshmitarët tjerë si SH.G., A.G., F.B. dhe A.P., por edhe provave materiale e sidomos ekspertizën e psikiatrisë, ku është vërtetuar gjendja shëndetësore e tani të akuzuarit dhe është konstatuar se i njëjti ka vepruar në gjendje të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, për të cilat, po ashtu, gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme, e që kanë mbështetje edhe në provat tjera materiale, si raportit nga vendi i ngjarjes, skicës së vendit të ngjarjes, raportit të obduksionit dhe foto dokumentacionit nga vendi i ngjarjes, ku pastaj edhe ka konkluduar se në rastin konkret në këtë çështje penalo-juridike bëhet fjalë për vepër penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 3 të KPRK-së, të kryer nga i akuzuari në gjendje të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, e jo sikur që pretendohet nga i akuzuari, se vrasja është kryer me armë zjarri nga persona tjerë.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe gjetjet e gjykatës.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, me ankesë, në esencë kontestohet vetëm mënyra e vlerësimit të provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë si dhe konkludimet të cilat ajo i ka nxjerrë të bazë të provave të proceduara. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, prandaj edhe përfundimet kanë pasuar të gabuara, pa mbështetje në prova. Kështu, sipas pretendimeve të mbrojtësit të akuzuarit, aspak nuk kontestohen faktet dhe rrethanat përkitazi me vrasjen e tani të ndjerit Ismail Kastrati natën kritike dhe atë me mjet të fortë, e as mënyrën e vrasjes, gjë që është edhe vërtetuar nga raporti i obduksionit por edhe ekspertiza mjeko- ligjore, mirëpo me asnjë provë në shkresat e lëndës, nuk është vërtetuar se pikërisht Sh.K. është personi që e ka privuar nga jeta tani të ndjerin Ismail Kastrati, për çka, pretendohet se gjykata e shkallës së parë, ka bërë edhe shkelje të ligjit penal kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për vepër penale, vrasje e rëndë, nga neni 179 par. 1 nën par. 3 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit, konstaton, se edhe përkitazi me këtë bazë ankimore nuk qëndrojnë pretendimet e cekura si me lartë, nga se me pa mëdyshje, pra edhe nga vetë mbrojtja e të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar fakte dhe rrethanat se natën kritike, në shtëpinë e tij ishin vetëm i akuzuari dhe gjyshi i tij – tani i ndjeri Ismail Kastrati, ku pasi qëndrojnë gjatë gjithë natës, tani i ndjeri në mëngjes është gjetur i vdekur në dhomën e tij të fjetjes dhe atë i goditur me mjet të fortë në kokë, ku i ishin shkaktuar tri plagë dhe si pasojë e goditjeve në fjalë, ka mbetur i vdekur në vendin e ngjarjes. Faktet dhe rrethanat në fjalë, përveç mbrojtjes së të akuzuarit gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe nga deklaratat e dëshmitarëve S.K., SH.G., A.G., F.B. dhe A.P., fakte këto dhe rrethana që kanë mbështetje, pastaj, edhe në provat materiale, si skica e vendit të ngjarjes, raporti i obduksionit për tani të

ndjerin, ekspertiza mjeko-ligjore, foto dokumentacioni por edhe ekspertiza e ekspertëve të psikiatrisë, ku edhe është vërtetuar se i akuzuari në rastin konkret ka vepruar në gjendje të përgjegjësisë esencialisht të zvogëluar mendore.

Ndërsa, përkitazi me faktet kontestuese, se a privoi nga jeta tani të ndjerin, i akuzuari Sh.K., gjykata e shkallës së parë, ka marrë parasysh së pari deklaratën e vetë të akuzuarit, i cili ka deklaruar se ka qenë vetëm gjatë tërë natës me tani të ndjerin në shtëpi dhe se të gjitha dyert e hyrjes kanë qenë të mbyllura dhe se në shtëpi nuk ka mundur të futet as motra e tij Serenata, derisa të nesërmen është futur përmes dritares dhe pastaj brenda në dhomën e fjetjes e ka gjetur gjyshin e saj të vdekur, për çka i akuzuari i ka thënë se është vrarë me armë zjarri nga persona të panjohur. Pastaj, gjykata e shkallës së parë, ka dëgjuar dëshmitaren S.K., e cila ka vërtetuar se pasi është kthyer në shtëpi në orët e vona të natës, ka trokitur disa herë por derën nuk ia ka hapur i akuzuari, ku pastaj ka fjetur tek shoqja e saj deri në mëngjes dhe pasi të nesërmen, në orët e pasdites, është kthyer nga puna prapë ka provuar për të hyrë në shtëpi dhe prapë dyert kanë qenë të mbyllura, ndërsa i akuzuari nuk ia ka hapur derën, atëherë e njëjta nga pjesa e prapme e shtëpisë duke shfrytëzuar një dritare, pasi e thyen xhamin më parë, është futur në shtëpi ku ka takuar të akuzuarin Sh.K., i cili i ka thënë se gjyshi ka vdekur dhe se është vrarë me armë zjarri nga persona të panjohur. Nga dëshmitari në fjalë, gjykata e shkallës së parë, po ashtu ka vërtetuar se i akuzuari nuk është në gjendje të mirë shëndetësore dhe se i njëjti edhe më parë është vizituar disa herë tek mjekët – psikiatër, për çka, e kanë ditur edhe të gjithë banorët e lagjes se i njëjti nuk është mirë me shëndet, se në shtëpi kanë jetuar së bashku, dëshmitari, i akuzuari dhe gjyshi i tyre, tani i ndjeri I.K.. Faktet dhe rrethanat në fjalë, i kanë vërtetuar edhe dëshmitarët tjerë, e që kanë mbështetje edhe në provat materiale, ndërsa nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes – teknika kriminalistike, është vërtetuar se në shtëpinë ku është kryer vrasja të gjitha dyert dhe dritaret kanë qenë të mbyllura dhe jo të hapura me dhunë, që do të thotë se përveç të akuzuarit dhe tani të ndjerit, askush tjetër nuk është futur në mënyrë të dhunshme në shtëpi, ndërsa, nga ekspertiza – raporti i autopsisë, është vërtetuar se tani i ndjeri ka vdekur si pasojë e goditjeve me mjet të fortë, ku i janë shkaktuar tri plagë shquese dhe nga gjakderdhja është shkaktuar vdekja, që do të thotë se nuk është përdorur kurrfarë armë e zjarrit, sikur që ka deklaruar i akuzuari, ndërsa në bazë të ekspertizës së psikiatrisë, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se i akuzuari vuan nga sëmundja me çrregullime mendore-skizofreni paranoide, e që është vërtetuar se i njëjti në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë me aftësi mendore esencialisht të zvogëluar mendore, sëmundje kjo për të cilën i akuzuari ka qenë i kontrolluar tek psikiatri edhe disa herë më parë.

Duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e sipër përmendura si dhe rrethanat dhe arsyerat më detajisht të theksuara në aktgjykimin e ankimuar, rezulton se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari Sh.K., ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 3 të KPRK-së, në gjendje të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, është i drejte dhe se në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarrë veprimet inkriminuese të cilat përbëjnë tiparet e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, prandaj, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, nga se me asnjë provë nuk vërtetohet se tani të ndjerin e kishte privuar nga jeta person tjetër me përdorimin e armës, sikur që pretendohet nga i akuzuari. Një konkludim i tillë, nga gjykata e shkallës së parë, vërtetohet edhe në bazë të fakteve dhe rrethanave, se i akuzuari ka qenë gjatë tërë natës vetëm me tani të ndjerin dhe se tani në shtëpi nuk ka qenë askush tjetër, ndërsa, i ndjeri është qëlluar me mjet të fortë e jo me armë dhe se me ekspertizë përkatëse është vërtetuar se askush tjetër nuk është futur me dhunë në shtëpi përveç të akuzuarit, pastaj, se të gjitha dyert e shtëpisë kanë qenë të mbyllura dhe të kyçura, ashtu që askush nuk ka mundur të hyjë brenda, atëherë pa dyshim që i akuzuari Sh.K. është personi që ka kryer vepër penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 3 të KPRK-së, e që duke pasur parasysh gjendjen e tij shëndetësore, është vërtetuar se në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë me aftësi esencialisht të zvogëluar mendore, prandaj edhe nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se tani i ndjeri Ismail Kastrati është privuar nga jeta me armë zjarri nga persona të tjerë.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, nuk janë të bazuara. Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, përkitazi me këtë bazë ankimore pretendohet se dënimi është i ashpër, sidomos kur merren parasysh rrethanat lehtësuese të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, e pastaj se në rastin konkret bëhet fjalë për vepër penale të vrasjes së kryer me përgjegjësi esencialisht të zvogëluar mendore, atëherë domosdoshmërisht është dashur që të akuzuarit t'i shqiptohet vetëm masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik por jo edhe dënimi me burgim.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në ankesën e paraqitur nga mbrojtja nuk janë theksuar rrethana tjera lehtësuese të cilat kishin me pasur ndikim të drejtë për drejtë në lartësinë e dënimit, por faktikisht vetëm janë përsëritur rrethanat të cilat edhe ashtu i ka pasur parasysh edhe gjykata e shkallës së parë, për çka kjo gjykatë vlerëson se në mënyrë të drejtë dhe të plotë janë konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, sikurse edhe parashihet me dispozitat e nenit 73 të KPK, kështu që në rastin konkret rrethanat lehtësuese të vlerësuara, se i akuzuari është i gjendjes së varfër ekonomike, ndaj tij nuk

zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, e sidomos si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjendjen e tij shëndetësore- pra, faktin se vepra penale në fjalë është kryer në gjendje të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, atëherë pa dyshim që rrethanat e konstatuara dhe vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana, rrethanat e cekura me aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret, pastaj mënyrën si është kryer vepra penale, por edhe natyrën dhe llojin e veprës penale, rezulton se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë, e së bashku me këtë edhe masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në harmoni me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, po ashtu, dënimi është edhe në funksion të preventivës gjeneralë dhe asaj individuale dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPK.

Në rastin konkret në këtë çështje penale-juridike duke pasur parasysh se i akuzuari veprën penale e ka kryer në gjendje të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, por edhe gjendjen e tij shëndetësore momentale, pra, edhe pas kryerjes së veprës penale, e që është konstatuar edhe me ekspertizën e psikiatrisë në shkresat e lëndës, e me këtë rrezikun e mëtutjeshëm për familjen por edhe rrethin ku jeton i akuzuari, atëherë edhe vendimi për masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, është i drejtë dhe i ligjshëm e në funksion të parandalimit të kryerjes së veprave tjera penale, por edhe shmangien e rrezikut serioz për familjen dhe rrethin ku jeton i akuzuari.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.403/2017, më 22.09.2017

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Anëtarët e kolegjit,

Kryetare e kolegjit,
Tonka Berishaj

1. Xhevdet Abazi

2. Abdullah Ahmeti